

Taulant Bajrami, PhD¹

UDC:
343.91-053.6:343.24(497.115)

MASAT NDAJ TË MITURVE DELIKUENTË NË KOSOVË

МЕРКИТЕ СПРЕМА МАЛОЛЕТНИЧКИТЕ ДЕЛИНКВЕНТИ ВО КОСОВО

MEASURES FOR THE JUVENILE DELINQUENT IN KOSOVO

Abstract

Democratic states make a clear distinction in their criminal legislation between juvenile and adult offenders, a distinction which consists both in their position in the criminal procedure where a particular procedure is provided for juveniles, and even regarding the criminal sanctions which are more of a soft character where measures of non-institutional character are being imposed mostly, and even penalties being imposed in rare cases such as criminal offenses. Bearing in mind the role of juveniles for the society, they should be treated as victims and not as criminals, even if their behaviors may be seen risky and threatening. This on no account can mean that they can be forgiven for their behavior but they should be treated in a particular way in order to contribute positively in their rehabilitation through these measures. The aim of this paper is to analyze all kinds of measures as criminal sanctions which are stipulated by the Juvenile Justice Code of Kosovo in order to elaborate the main characteristics of these measures, types and procedures of their enforcement in Kosovo.

¹ Autori është Phd. Cand. në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe asistent në Kolegjin “Fama”- Prishtinë

Hyrje

Në legjislacionin penal të Kosovës trajtimin të fëmijëve të cilët bien në konflikt me ligjin i kushtohet kujdes i posaçëm, duke miratuar një ligj të veçantë Kodin e drejtësisë për të mitur në vitin 2010, dispozitat e të cilit rregullojnë të gjitha çështjet e drejtësisë për të mitur. Kodi i drejtësisë rregullon trajtimin e të miturit si kryerës i veprës penale, fëmijës dhe të miturit si pjesëmarrës në procedurë, e cila bazohet në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke marrë parasysh interesat më të mira të të miturve, duke marrë parasysh pjekurinë e tyre, nivelin e zhvillimit, aftësive dhe veçorive personale, si dhe peshën e veprës, me qëllim të rehabilitimit dhe riintegrimin e të tyre shoqëror. Kodi i Drejtësisë përcakton masat dhe dënimet të cilat mund t'i shqiptohen të miturve në konflikt me ligjin, të cilat janë edhe objekt i këtij punimi në vejanit masat e parapara ndaj të miturve. Në këtë punim është trajtuar disa çështje kryesore lidhur me këto masa ndaj të miturve si karakteristikat e këtyre masave, personat ndaj të cilëve mund të shqiptohen këto masa, kushtet të cilat duhet të plotësohen për shqiptimin e këtyre masave, llojet e këtyre masave, organet përgjegjëse për caktimin e këtyre masave, dhe procedure e shqiptimit të tyre . Punimi përmban të dhëna statistikore mbi numrin e shqiptimit të këtyre masave dhe llojet e këtyre masave të shqiptuara nga Gjykatat në Kosovë.

I. PERKUFIZIMI I DELIKUENCËS SË TË MTURVE

Termi delikuencë vjen nga fjala latine “deliquare” që ka një kuptim shumë të gjerë. Ka pasur mjaft tentime që të përcaktohet dhe të shpjegohet saktësisht domethënia e kësaj fjale, mirëpo është parë se një përcaktim i tillë nuk është pranuar, ngase kuptimi dhe brendia e termit varej shumë nga sistemet dhe ligjet e shtetit, si dhe nga këndvështrimi shkencor (psikologjik, pedagogjik, mjekësor, juridik etj.) i këtij problemi. Me termin delikuencë e të miturve zakonisht i referohemi shprehive, sjelljeve dhe veprimeve të përsëritura të të miturve që bien ndesh me moralin, zakonet dhe ligjet e mjedisit ku jetojnë. Delikuent quhet ai person që ka sjellje të përsëritura devijuese, që bën vepra kriminale, duke shkelur kështu normat ligjore në fuqi dhe rregullat e shoqërisë ku jeton.

Kodi penal i Kosovës në pjesën e përkufizimeve të shprehjeve të përdorura në kod, në mes shprehjeve tjera ka përkufizuar termin fëmijë dhe termin i mitur. Sipas kodit termi fëmijë i referohet personit i cili

nuk ka mbushur moshën 18 vjet². Ndërsa me termin i mitur i referohet personit ndërmjet moshës 14 dhe 18 vjet³. Po të njëjta kuptime të këtyre shprehive i ka adaptuar edhe Kodi i drejtësisë për të mitur, i cili për dallim nga Kodi penal ka bërë edhe zberthimin e mëtutjeshëm të termit i mitur. Sipas këtij kodi, termi i mitur i referohet dy kategori të të miturve dhe atë të miturit të ri dhe të miturit të rritur.

Me termin i mitur i ri i referohet personit ndërmjet moshës 14 dhe 16 vjet⁴. Ndërsa me termin i mitur i rritur i referohet personit ndërmjet moshës 16 dhe 18 vjet⁵. Kjo ndarje apo kategorizim i të miturve, në aspektin praktikë ka rëndësi të madhe në procedurën penale ndaj të miturve, sepse së pari përcakton moshën që një person të ndiqen penalisht si të mitur, domethënë që janë mbi moshën “minimale për përgjegjësi penale” e cila sipas këtij kodi është mosha 14 vjet, dhe pastaj në varësi nga mosha përcaktohet edhe lloji i masave apo dënimeve penale të cilat mund të shqiptohen ndaj personave të mitur, të cilat sipas Kodit të miturit të ri mund t’i shqiptohet vetëm ndonjëra nga masat si ato të diversitetit ashtu edhe ato masat edukative, ndërsa si moshë të përgjegjësisë penale për shqiptimin e dënimeve e përcakton moshën 16 vjet apo të ashtuquajturit të miturit e rritur.

Pra, siç shihet nga këto përkufizime termi fëmijë ka një domethënie më të gjerë i cili në vete përfshin një rreth më të zgjeruar të personave, brenda të të cilit përkufizim përfshihen edhe vetë personat e mitur - personat midis moshës 14 deri në 18 vjet.

II. LLOJET E MASAVE DHE DËNIMEVE NDAJ TË MITURVE

Kodi i drejtësisë për të mitur parasheh se të miturve të cilët kryejnë vepra penale, mund t’i shqiptohen: Masat dhe dënimet. Mirëpo përveç këtyre ndaj të miturve mund të shqiptohen edhe masat për trajtim të detyrueshëm. Si kriter kryesor në përcaktimin se cili sanksion do të shqiptohet merret për bazë mosha e personit të mitur i cili ka kryer vepra penale. Sipas këtij kriteri nëse i mituri kryen vepra penale në moshën mes 14 dhe 16 vite ndaj tij mund të shqiptohet vetëm ndonjë nga llojet

² Kodi Penal i Kosovës, Neni 120, paragrafi 20.

³ Po aty, paragrafi 21.

⁴ Kodi i drejtësisë për të mitur, Neni 2, paragrafi 1.3.

⁵ Kodi i drejtësisë për të mitur, Neni 2, paragrafi 1.4.

e masave të parapara, ndërkaq për shqiptimin e dënimit si sanksion penale si kriter kryesor merret moshë minimale e përgjegjësisë penale për shqiptimin e këtij sanksioni e cila është 16 vite⁶. Pra, sipas këtyre dispozitave personave të mitur nën moshën 16 vite në asnjë rast nuk mund t'i shqiptohet dënimi.

Mirëpo si masa të veçanta me karakter mjekësor kodi i drejtësisë për të mitur i parasheh edhe masat e trajtimit të detyrueshëm të cilat si të tilla janë të ndara nga llojet e sanksioneve penale.

2.1. Masat e zbatueshme ndaj të miturit

Kodi i drejtësisë për të mitur parasheh dy lloje të masave të cilat mund të shqiptohen ndaj të miturit, dhe atë : Masat e diversitetit dhe masat edukuese.

2.1.1. Masat e diversitetit

Masat e diversitetit për here të parë në legjislacionin penal të Kosovës janë paraparë në kodin e drejtësisë për të mitur të vitit 2010. Këto masa përfaqësojnë llojin e masave më të lehta të cilat janë të parapara me këtë kod dhe të cilat mund t'u shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale. Sa i përket kohëzgjatjes së tyre ky kod nuk e ka rregulluar në mënyrë taksative këtë aspekt, por e ka lënë në diskrecion të gjykatësit, në mënyrë që në vartësi nga rrethanat e rasti konkrete të vendosë vetë gjykatësi për gjatësinë e shqiptimit të njërën nga këto masa, mirëpo gjykatësi me rastin e shqiptimit të kohëzgjatjes së tyre duhet të ketë parasysh interesin më të mirë të të miturve, dhe duhet të përcaktohen në kohë zgjatje sa më të shkurtër të mundshëm. Ndaj kryerësit të mitur të veprës penale varësisht nga rrethanat e rastit konkret mund të shqiptohen një ose më shumë masa të diversitetit.

Qëllimin e shqiptimit të masave të diversiteti Kodi i Drejtësisë për të Mitur e ka përcaktuar në nenin 16 në të cilin përcaktohet “ Qëllimi i masave të diversitetit është që të parandalojë, kur është e mundur, fillimin e procedurës ndaj kryerësit të mitur, të ndihmojë rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e të miturit në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste”

Pra siç shihet edhe nga ky nen dalin disa qëllime kryesore për të cilat shqiptohen këto masa ;

- Që ndaj të miturve të mos zhvillohet procedura penale

⁶ Kodi i Drejtësisë për të mitur, Neni 7, paragrafi 3.

- Të shmangët shqiptimi i sanksionit penale
- Të ndikoj në rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve dhe të shmangë stigmatizimin e të miturve

- Pengimin e recidivizmit tek të miturit⁷

Për tu shqiptuar masave të diversitetit, kodi i drejtësisë për të mitur në nenin 17 parasheh dy lloj kushtesh :

- Kushti i parë i cili i referohet veprës penale, dhe
- Kushti i dytë i cili i referohet personalitetit të kryerësit të veprës penale.

Sipas zgjidhjes së kësaj dispozite të dy këto kushte si aj i veprës penale ashtu edhe kushti i cili i referohet personalitetit të kryerësit të veprës penale duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, në mënyrë që ndaj kryerësit të mitur të shqiptohen masat e diversitetit.

1) Kushti i cili i referohet veprës penale përcakton se masat e diversitetit mund të shqiptohen ndaj të miturit i cili ka kryer veprë penale për të cilën është paraparë si dënim kryesor gjoja ose dënimi me burgim deri në 3 vite ose për veprat penale të kryer nga pakujdesia për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në 5 vite, me përjashtim të veprave penale të cilat kanë rezultuar me humbje të jetës së njerëzve.

2) Kushti i dytë mbi bazën e të cilave kryesit të mitur mund t'i shqiptohen masat e diversitetit ka të bëjë me personalitetin e kryerësit të veprës penale. Ky kusht përcakton disa veprimi nga kryerësi i mitur i veprës penale të cilat duhet t'i ndërmarrë në mënyrë që të shqiptohen masat e diversitetit e të cilat kanë të bëjnë me: a) Pranimin e përgjegjësisë për veprën penale nga i mituri, b) Shprehjen e gatishmërisë nga i mituri që të pajtohet me palën e dëmtuar, c) Pëlqimin e të miturit ose prindit, prindit adaptues ose kujdestarit në emër të të miturit për të zbatuar masën e shqiptuar të diversitetit.

Vetëm pasi i mituri ka plotësuar këto kushte mund t'i shqiptohet një nga llojet e këtyre masave të cilat janë :

- Pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtua, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar,
- Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij,
- Kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit,
- Vijimi i rregullt në shkollë,

⁷ Azem Hajdari, *Sistemi i Drejtësisë për të mitur*, Prishtinë, 2010, f. 47.

- Pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij,
- Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej 10 deri 60 orë,
- Edukimi me rregullat e trafikut
- Këshillimet psikologjike.

2.1.2. Masat edukative

Masat edukative janë masa qëllimi i të cilave është që të kontribuojë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe kështu duke ndaluar sjelljen recidiviste.

Masat edukative kanë për qëllim të fundit që i mituri, pas zbatimit të masës së shqiptuar edukative të fillojë të veprojë në përputhje me rregullat ligjore dhe në instancë të fundit të evitohet mundësia që ai të shndërrohet në recidivist⁸.

Masat edukative janë masa shtrënguese shtetërore të cilat kanë disa karakteristika si:

- Shqiptohen vetëm nga gjykata
- Shqiptohen pavarësisht nga gatishmëria dhe vullneti i të miturit për ta respektuar
- Konsistojnë në kufizimin e disa të drejtave dhe lirive të të miturve të cilët vendosen në institucione edukuese, duke imponuar një regjim të veçantë jetese
- Nuk kanë pasoja juridike në statusin e të miturit ndaj të cili janë shqiptuar, nuk regjistrohen në regjistrin gjyqësor
- Lartësia e tyre nuk mund të jetë më e lartë se sa dënimi i paraparë për atë vepër penale

Kodi i drejtësisë për të mitur i parasheh tri lloje të masave edukative të cilat mund t'i shqiptohen të kryerësit të mitur, si të tilla janë

1. masat disiplinore,
2. masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe
3. masat institucionale⁹

⁸ Po aty, f. 54

⁹ Kodi i drejtësisë për të mitur, Neni 20, paragrafi 1.

2.1.2.1. Masat Disiplinore

Masat disiplinore ndaj të miturve konsiderohen masat më të lehta edukative që mund të shqiptohen ndaj kryesve të mitur. Këto masa kryesisht shqiptohen për vepra të lehta penale. Zakonisht kemi të bëjmë me persona të mitur që kanë kryer vepra penale si rezultat i pakujdesisë së tyre dhe të mungesës së përgjegjësisë personale. Masat disiplinore i shqiptohen të miturve veprimi delikuent i të cilëve është me tepër rezultat i disa rrethanave të rastit, prandaj konsiderojmë se me masa me të lehta mund të ndikoj që personi i tillë të përmirësohet dhe të heq dorë nga sjellja e tillë devijuese apo delikente. Masat disiplinore janë qortimi gjyqësor dhe dërgimi i të miturit në qendër disiplinore. Këto masa shqiptohen ndaj kryerësit të mitur interesat e të cilit më së miri përfillen me një masë afatshkurtër, veçanërisht nëse vepra penale është kryer nga pamaturia apo pakujdesia¹⁰.

Qortimi gjyqësor është masa më e lehtë edukative e cila mund t'i shqiptohet të miturit si kryes i veprës penale. Nga dispozitat e nenit 21 të kodit të drejtësisë për të mitur, rrjedh se qëllimi i shqiptimit të qortimit gjyqësor është që në të njëjtën kohë të vetëdijësohet i mituri se ka kryer vepër penale dhe t'i tërhiqet vërejtja se nëse vazhdon me sjellje të tilla, ndaj tij do të shqiptohet masë tjetër më e rëndë.

Masë tjetër e paraparë në kuadër të masave disiplinore është dërgimi në qendrën disiplinore. Edhe kjo masë si edhe qortimi gjyqësor shqiptohet në rastet kur i mituri ka kryer vepër penale si pasojë e pakujdesisë apo mendjelehtësisë së tij. Ekzekutimi i kësaj mase bëhet në një institucion të kujdesit të posaçëm i cili ka rol edukativ. Për tu shqiptuar kjo masë duhet të plotësohen dy kushte, kushti i parë është që gjykata të ketë krijuar bindje se shqiptimi i masës së tillë është i mjaftueshëm për të ndikuar pozitivisht në sjelljen e të miturit në të ardhmen, ndërsa kushti i dytë i referohet bindjes së gjykatës se masa është në funksion të interesave të të miturit¹¹.

Ndërsa sa i përket kohëzgjatjes së shqiptimit të kësaj mase kodi ka përcaktuar se i mituri mund të dërgohet në qendër disiplinore më së shumti 1 muaj, deri në 4 orë në ditë, ose më së shumti 4 ditë gjatë festave shkollore apo publike deri në 8 orë në ditë¹².

¹⁰ Po aty, neni 20, paragrafi 2.

¹¹ Azem Hajdar, *Sistemi i drejtësisë për të mitur*, Prishtinë, 2010, f. 58.

¹² Kodi i drejtësisë për të mitur, neni 22, paragrafi 2.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i të miturve ndaj të cilëve është shqiptuar kjo masë gjatë viteve 2014 - 2015. Në vitin 2014 nga 840 sanksione penale sa u janë shqiptuar të miturve, 22 të miturve i është shqiptuar masa disiplinore që përbën në numër total 2,6 % të sanksioneve penale të shqiptuara të atij viti. Ndërsa në vitin 2015 ka qenë numër minimal i shqiptimit të tyre duke shqiptuar këtë masë vetëm ndaj 2 të miturve apo 0,4 % të sanksioneve penale të shqiptuara në vitin 2015¹³.




Tabela nr. 1. Numri i të miturve ndaj të cilëve i është shqiptuar masat disiplinor

2.1.2.2. Masat e mbikëqyrjes së shtuar

Masat e mbikëqyrjes së shtuar janë lloji më i shpeshtë i masave edukative të cilat u shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale, për shkak se me shqiptimin e tyre shmanget privimi i të miturit nga liria. Edhe nga të dhënat e jurisprudencës vërehet se lloji më i madh i sanksioneve penale që i shqiptohen të miturit janë masat e mbikëqyrjes së shtuar. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i të miturve të cilëve i është shqiptuar kjo masë në periudhën 2014-2015. Në periudhën 2015, 62,5 % e numrit të përgjithshëm të sanksioneve penale kanë qenë të shqiptuar nga masat e mbikëqyrjes së shtuar apo ndaj 350 të miturve. Gati pothuajse e njëjta vlerë në përqindje është edhe në vitin 2014, ku

¹³ Statistikat e jurisprudencës për persona të mitur 2014-2015, Agjencia e Statistikave të Kosovës, tabela 6.

nga 840 të miturve që u janë shqiptuar sanksione penale, 62,3 % e tyre apo 523 të miturve i është shqiptuar kjo masë¹⁴.




Tabela nr. 2. Numri i të miturve ndaj të cilëve është shqiptuar Masa e mbikëqyrjes së shtuar gjatë viteve 2014 dhe 2015

Kodi i drejtësisë për të mitur i njeh tri lloj të këtyre masave të cilat mund t'i shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale:

- Mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, nga prindi adoptues ose kujdestarit të të miturit,
- Mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhe
- Mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë¹⁵

Masën mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, nga prindi adoptues ose kujdestarit të të miturit gjykata e shqipton kur plotësohen dy kushte dhe atë: Kushti i parë është qe vepra penale të jetë kryer për shkak të mos ushtrimit të mbikëqyrjes dhe edukimit nga ana e prindërve, adoptuesit, apo kujdestarit. Kushti i dytë është se kjo masë edukues mund të shqiptohet nëse konstatohet se prindërit adoptues apo kujdestari i të miturit kanë mundësi dhe aftësi ta ushtrorjnë mbikëqyrjen dhe edukimin e tij¹⁶. Po ashtu kur gjykata shqipton këtë masë ajo mund të urdhërojë prindin, prindin adoptues, ose të kujdestarit të të miturit udhëzime dhe

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Kodi i drejtësisë për të mitur, neni 20, paragrafi 3.

¹⁶ Ismet Salihu, E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2005, f. 42-44.

urdhra për përmbushjen e detyrave të caktuara për të realizuar mbikëqyrjen në mënyrë më efektive dhe urdhëron shërbimin sprovues për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj mase.

Masa e mbikëqyrjes së shtuar në familjen tjetër aplikohet ndaj të miturve në rastet kur në familjen e personit të mitur nuk ka kushte për zbatimin e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit. Kjo masë aplikohet në ato raste kur prindërit apo kujdestari nuk janë në gjendje që ta kryejnë mbikëqyrjen dhe kontrollin e shtuar ndaj të miturit, për arsye të paaftësisë fizike dhe psikike, për shkak të sëmundjeve të ndryshme, për shkak të pranisë së dukurisë së alkoolizmi, narkomanisë dhe dukurive të tjera patologjike¹⁷. Për t'u shqiptuar kjo masë familja tjetër duhet t'i plotësojë disa kushte të caktuara si dhe familja të pajtohet me zbatimin e masës së shqiptuar. Gjykata kompetente me propozim të shërbimit sprovues cakton familjen në të cilën vendoset i mituri ndaj të cilit është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së shtuar në familjen tjetër, në raste të tilla përparësi i jepet familjes me të cilën i mituri është në lidhje farefisnore apo është i lidhur emocionalisht¹⁸. Ndërsa sa i përket kohëzgjatjes së kësaj mase kodi nuk e përcakton në mënyrë taksative, por sipas kodi kjo masë përfundon atëherë kur pushojnë shkaqet të cilat e kanë bërë të pa aftë prindin, prindin adaptues ose kujdestarin e të miturit të paaftë për ushtrimin e mbikëqyrjes.

Masë tjetër në kuadër të masave të mbikëqyrjes së shtuar është mbikëqyrja nga ana e organit të kujdestarisë. Këtë masë gjykata e shqipton kur plotësohen dy kushte, kushti i parë që gjykata të ketë marrë në pyetje prindin, prindin adaptues apo kujdestarin, dhe kushti i dytë që gjykata të jetë e bindur nga kjo bisedë se këta persona nuk janë në gjendje ta ushtrjnë këtë masë¹⁹. Gjatë ekzekutimit të kësaj mase i mituri mbetet me prindin e tij Me rastin e shqiptimit të kësaj mase, organi përgjegjës e cakton zyrtarin përgjegjës për ekzekutimin e kësaj mase. Organi i kujdestarisë harton planin e punës që duhet të zbatohet lidhur me ekzekutimin e kësaj te mbikëqyrjes së shtuar. Ky plan përmban detyrime dhe obligime si te personit të miturit ashtu edhe te organeve te kujdestarisë. Personi zyrtar është i obliguar që personalisht dhe me rregull të mbajë kontakt me personin e mitur të organizojë biseda, vizita dhe mënyra te tjera te përshtatshme te ndikimit dhe mbikëqyrjes.

¹⁷ Ragip Halili, *Penalogjia*, Prishtinë, 2014, f. 264.

¹⁸ Kodi i drejtësisë për të mitur, neni 94.

¹⁹ Azem Hajdari, *Vepra e cituar*, f. 65.

2. 1.2.2. Masat edukative institucionale

Masat edukative institucionale janë masa që u shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale ndaj të cilëve duhet të ndërmerren masa më afatgjate të edukimit nga institucionet e specializuara në këtë fushë. Vendosija e personave të mitur në ente dhe institucione të veçanta arsyetohet edhe me faktin se ambienti i deritanishëm ka pasur ndikim negativ dhe vlerësohet se është e domosdoshme që ata të largohen edhe në mënyrë fizike për një kohë të caktuar nga ai ambient, me qëllim të eliminimit të ndikimeve të tilla dhe krijimit të shprehive e vetive të reja konstruktive²⁰. Masa të tilla institucionale janë dërgimi i të miturit në institucion edukues, dërgimi i të miturit në institucion edukues korrek-tues dhe dërgimi i të miturit në institucion të kujdesit të posaçëm²¹.

Kjo masë në vitin 2015 nga gjykata është shqiptuar ndaj 15 të miturve nga gjithsej 563 të miturve sa u janë shqiptuar sanksione penale, apo në 2,7 % të rasteve. Ndërsa në vitin 2014, i është shqiptuar ndaj 56 të miturve, nga 840 të mitur që kanë qenë me sanksione penale, e cila përbën 6,7 % të sanksioneve të shqiptuara në këtë vit²².




Tabela nr. 3 Numri i masave edukative të shqiptuara ndaj të miturve në vitin 2014 - 2015

²⁰ Liridon Maloku, *Ekzekutimi i masave edukative*, Revista shkencore “Justica”, nr.1/2012, Prishtinë, 2012, f.337

²¹ Kodi i drejtësisë për të mitur, neni 20, paragrafi 3.

²² Statistikat e Jurisprudencës për të mitur 2014 – 2015, Agjencia e Statistikave të Kosovës, tabela 6.

Masën edukative dërgim në institucion edukativ gjykata e shqipton kur vjen në përfundim se edukimi dhe riedukimi i të miturit delikuent nuk mund të arrihet pa ndarjen e plotë të të miturit nga mjediset ku jeton dhe vepron dhe pa ndërmarrjen e masave afatgjate edukuese dhe riedukuese. Shërbimi sprovues i Kosovës ka një rol kyç në ekzekutimin e kësaj mase, ngaqë është mbikëqyrëse e ekzekutimit të kësaj mase. Gjykata këtë masë e shqipton në intervalin kohor jo më të shkurtër se 3 muaj e as më të gjatë se 2 vite, megjithatë gjykata çdo 6 muaj shqyrton nëse akoma ka nevojë për ekzekutimin e kësaj mase, apo qëllimi i kësaj mase është arritur.

Dërgimi në institucionin edukativo-korrektues është masa më e rëndë e paraparë me kodin e drejtësisë për të mitur, e cila i shqiptohet kryerësve të mitur të veprave penale ndaj të cilët është e nevojshme ndërmarrja e masave dhe trajtimit më të specializuara nga institucionet edukative. Institucioni edukativo-korrektues u ofron të miturve mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje të specializuar nga profesionistët me qëllim të riedukimit dhe arsimimit të suksesshëm të tyre. Personeli i shtëpisë edukuese-përmirësuese, veçmas angazhohet për zhvillimin dhe formimin e vetive dhe shprehive pozitive të personave të mitur gjatë qëndrimit në këto institucione edukative²³. Kodi i drejtësisë për të mitur përcakton se për ta shqiptuar gjykata këtë masë duhen të plotësohen dy kushte, kushti i parë kërkon që i mituri të ketë kryer vepra penale dënimi për të cilën është paraparë në kohëzgjatje prej më shumë se 3 vite dhe kushti i dytë kërkon që përmes kësaj mase i referohet nevojave që ka i mituri për edukim të specializuar²⁴. Po ashtu nga gjykata kërkohet që me rastin e shqiptimit të kësaj mase të ketë parasysh peshën e veprës penale, si dhe nëse të miturit më parë i është shqiptuar masë edukative ose burgimi për të mitur. Dërgimin në institucion edukativo-korrektues si masë gjykata mund ta shqiptojë në kohëzgjatje prej 1 deri në 5 vite.

Masa edukative e dërgimit në institucionin për kujdes të posaçëm i shqiptohet personit të mitur i cili ka kryer vepra penale për shkak të çrregullimeve dhe ngecjeve të tij biopsikike dhe kur kjo është në interesin më të mirë të të miturit. Çdo i mituri i cili vuan nga sëmundjet mendore apo nga paaftësi tjera fizike e psikike, duhet të shërohet në një institucion të specializuar, nën drejtimin e pavarur mjekësor. Në këto raste fjala është për persona shurdh-memec, persona të verbër, persona

²³ Liridon Maloku, vepra e cituar, f. 340.

²⁴ Kodi i drejtësisë për të mitur, Neni 28.

me zhvillim të vonuar psikik dhe persona të mitur me çrregullime tjera shpirtërore dhe psikike. Për ta shqiptuar këtë masë gjykata duhet të plotësohen kushtet për shqiptimin e ndonjëres nga dy masat tjera paraprake, por ë cilat nuk mund të shqiptohen për shkak të specifikave të cilat i karakterizojnë delikuentët e mitur. Para shqiptimit të kësaj mase gjykata kërkon rekomandimin e ekspertit të mjekësisë se kjo masë është e nevojshme për trajtimin e të miturit. Sa i përket kohëzgjatjes së kësaj mase kodi i drejtësisë nuk e rregullon në mënyrë taksative, por përcakton se gjykata e cila e ka shqiptuar masën është e detyruar që çdo gjatë muaj të rishikojë nevojën për qëndrim të mëtutjeshëm në institucionin e kujdesit të posaçëm si dhe kur i mituri arrin moshën 18 vjet²⁵.

CONCLUSIONS

In the criminal legislation of Kosovo a special attention is paid to the treatment of juveniles in conflict with the law. A special law “Juvenile Justice Code” was adopted in 2010, its provisions regulating all matters regarding the issue of justice for juveniles. Justice Code regulates the treatment of juveniles as offenders, juveniles as participants in the procedure, which are based in the respect for human rights and fundamental freedoms and in the light of juvenile’s maturity, their level of development, the degree of their offense and personal specifics and skills, in order to help in the process of their rehabilitation and reintegration in society.

The Justice Code stipulates the sanctions which can be imposed to Juveniles in conflict with the law. In this paper, some of the main issues regarding these measures have been treated, such as: the characteristics of these measures, individuals on whom these measures can be imposed, conditions that have to be met through the enforcement of these measures, types of these measures, responsible organs for the enforcement and application of these measures, and the procedure of their application. The paper contains statistical data on the application of these measures and the types of the measures enforced by Courts in Kosovo.

In the legislative aspect Kosovo has made a significant progress when with the adoption of The Juveniles Justice Code has done the legal codification in a single law by which it has regulated the whole justice

²⁵ Po aty, neni 29

system for juveniles, regulating the whole procedure on juveniles starting from their appearance in police to the execution of their sanctions. Nevertheless in the application concretely in the execution of the sanctions it is facing various problem which create difficulties in achieving the effects and the aiming of the same.

The absence of professional staff, or the small number of the same in the relevant institutions that are competent for the enforcement and execution of these sanctions, appears to be the most predominant problem. For instance a report from the State Prosecution reveals the high number of indictments that a single prosecutor has to deal with. In the basic prosecution of Prishtina the average of indictments to be dealt by a single prosecutor goes to 187 which has created obstacles in the procedure on juveniles. Therefore the increase of the number of prosecutor is a necessity.

The lack of infrastructural objects for the execution of criminal sanctions on juveniles is another deficyeny. Currently, there is only one correctional center where sentenced juveniles are held and the execution of the educational measure is done in the same center which has a very negative influence on juveniles since the lack of categorization in this center makes the contact of juveniles with individuals with criminal past appear as a serious problem. Therefore it is of prior importance to categorize this Correctional Center for only one category of offenders (only for sentenced juveniles or detainees). The functionalization of objects for the execution of educational measure for juveniles is an issue posing a prior importance. The separation of juvenile females from the adult sentenced females should also take place.

In addition, there should be paid more attention in the enforcement of educational measures, there should be no double measures imposed for two different offenses, in a case the court had imposed a new measure without the first one having been executed. Only in the first months of 2016 such measures have been imposed in three cases according to the monitoring report of the coalition of NGO-s for the protection of children KOMF.

BIBLIOGRAFIA

- I. Azem Hajdari, Sistemi i drejtësisë për të mitur, Prishtinë, 2010
- II. Ismet Salihu , E drejta penale për te mitur, Prishtinë, 2005
- III. Ismet Salihu: E drejta penale - Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015.
- IV. Ragip Halili, Penalogjia, Prishtinë, 2014
- V. Liridon Maloku, Ekzekutimi i masave edukative, Revista shkencore “Justica”, nr,1/2012, Prishtinë, 2012
- VI. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2012.
- VII. Kodi i drejtësisë për të mitur i Kosovës, Prishtinë, 2010.
- VIII. Statistikat e jurisprudencës për persona të mitur 2014-2015